



RAPORT



PËR ANALIZËN E PËRGGJIGJEVE TË PYETËSORIT ONLINE

MBI

ECURINË E ZBATIMIT TË MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË

**PLOTËSUAR NGA MËSIMDHËNËSIT E LËNDËVE/MODULEVE
PROFESIONALE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE**

KONTEKSTI

Për shkak të situatës së krijuar pas shpërthimit COVID-19 që imponoi ndërprerjen për një periudhë të pacaktuar të funksionimit të gjithë sistemit arsimor në vend, shkollat profesionale u udhëzuan që të realizojnë “mësimin në kushtet e shtëpisë”. Për të mbështetur shkollat profesionale në këtë proces me kushte krejt të veçanta, përvoja të patestuara dhe vështirësi të paparishikuara, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) përgatiti dhe i'u ofroi stafit të këtyre shkollave një “Udhëzues për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional”.

Njëkohësisht, Agjencia u angazhua edhe në monitorimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të shkollave profesionale për mësimin online, nëpërmjet kontakteve, konsultimeve dhe shkëmbimit të informacionit me mësues, instruktorë dhe drejtues.



Marrja e informacionit të shpejtë dhe të detajuar për ecurinë dhe problematikat e mundëshme të mësimin në kushtet e shtëpisë, shërben si bazë për shmangjen e pengesave dhe përmirësimin e tij. Për këtë qëllim, AKAFPK përgatiti një pyetësor me 22 kërkesa/pyetje për tu plotësuar online nga mësuesit dhe instruktorët e lëndëve dhe moduleve profesionale të të gjitha shkollave profesionale publike. Drejtuesit e shkollave u informuan për nevojën, mënyrën dhe adresën e internetit për aksesimin e këtij pyetësori, i cili u plotësua masivisht nga mësuesit dhe instruktorët, brenda 3-4 ditëve.

Stafi i AKAFPK i analizoi me hollësi përgjigjet e të gjithë pyetësorëve të plotësuar dhe ka përgatitur këtë raport i cili përmban më poshtë konkluzione të përgjithshme dhe rezultatet e përgjigjeve për çdo pyetje.

KONKLUZIONE

Pyetësi u plotësua nga:

- ✓ 454 mësues të lëndëve profesionale dhe instruktorë të moduleve profesionale **nga të gjitha shkollat profesionale të vendit**. Kjo pjesëmarrje përbën rreth 70% e totalit të kësaj kategorie mësimdhënësish të vendit dhe kjo përbën një garanci për besueshmërinë e rezultateve të pyetësit.
- ✓ 200 mësues të lëndëve të kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, por meqenëse kjo kategori nuk ishte pjesë e objektit të pyetësit, rezultatet e përgjigjeve të tyre nuk janë përfshirë në këtë analizë.

ASPEKTET POZITIVE

Në përgjithësi, në përgjigjet e mësuesve vihet re një **këndvështrim pozitiv** për nismën e mësimit në kushtet e shtëpisë, si e vetmja mundësi për të vijuar procesin mësimor në shkollat profesionale edhe në kushtet jonormale të ndërprerjes dhe izolimit të imponuar nga përhapja e COVID-19.

Nga analiza e përgjigjeve rezulton që pjesa më e madhe e mësuesve dhe e nxënësve janë përkushtuar dhe përshtatur shpejt me kushtet dhe me kërkesat e reja të kësaj qasjeje të pa-përjetuar më parë.

Veçanërisht mësuesit, janë në kërkim të vazhdueshëm për të gjetur metodologji dhe zgjidhje që jo vetëm shmangin vështirësitë dhe pengesat, por edhe rrisin efektivitetin e mësimit online.

Shumica e mësuesve mendojnë që mësimi online, megjithë kohën e shkurtër që po zbatohet masivisht në shkollat profesionale, bart disa veçori dhe tipare që mundësojnë përballimin e situatës që po kalojmë, kohëzgjatja e së cilës ende nuk mund të parashikohet.

Tipare të tilla janë shpejtësia e komunikimit, dixhitalizimi, kostoja e ulët, përshtatshmëria e lartë, fleksibiliteti, krijimi i lidhjeve më të ngushta mësues-nxënës, nxënës-nxënës dhe nxënës-prind, përgjegjshmëria, kreativiteti dhe vet-studimi i nxënësve, kontrolli dhe vlerësimi i njëkohshëm etj.

Mangësitë




Mungesë ose akses i ulët në internet nga të gjithë nxënësit.

Mungesë e mos-përshtatshmëri e mjeteve për komunikimin online si celularë, smartphonë, kompjutera, laptopa, kamera etj.

Përdorimi i mjeteve dhe mënyrave të komunikimit online me pagesë.


Mungesë e adresave të e-maili-t nga një pjesë e nxënësve.



Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve të mësimin online të cilat jo gjithmonë janë të mundshme të përdoren nga të gjithë mësuesit dhe nxënësit.

Përdorimi i një numri të madh aplikacionesh (whatsapp, sms, telefonata, e-mail, facebook, instagram, zoom, google classroom, mesonet.al etj.) që krijojnë konfuzion.

Mungesë e një platforme unike kombëtare ose mbi bazë shkolle për mësimin online.



Mbingarkesë e nxënësve për shkak të mos-koordinimit të orarit të mësimin online.

Vështirësi në angazhimin e plotë dhe të njëkohshëm të të gjithë nxënësve në seancat e mësimin online.


Mungesë materialesh mësimore mbështetëse të gatshme për një pjesë të lëndëve profesionale dhe moduleve profesionale (burimet kryesore janë faqja e AKAFPK dhe interneti).



Vështirësi për përgatitjen e materialeve mësimore nga ana e vetë mësuesve.

Mbingarkesë e mësuesve për vlerësimin e nxënësve dhe besueshmëri e ulët e rezultateve të vlerësimit.

Mungesë interaktiviteti në shumicën e seancave online, thjesht jepen materiale dhe detyra dhe kërkohen detyrat e zgjidhura (mësim jo-sinkron)



Mungesë përvoja nga mësuesit dhe nxënësit për teknikat e mësimin online.

Mungesë vullneti dhe gadishmërie nga mësuesit dhe nxënësit për të përdorur platformat dhe aplikacionet me të cilat nuk janë familjarizuar.

Pjesëmarrje e ulët e nxënësve nga zonat rurale dhe nga familjet me vështirësi ekonomike.

Mangësitë

Në vijim, parashtrohen disa gjykime që kanë të bëjnë *besueshmërinë* e përgjigjeve dhe *seriozitetin* e plotësimit të pyetësorit nga një pjesë e mësuesve. Ka raste kur vihet re moskuptim i kërkesës së pyetjes dhe dhënie përgjigjesh që nuk kanë lidhje me të. Kjo tregon se një pjesë e mësuesve ende kanë koncepte jo të drejta për terminologjinë didaktike (metoda mësimore, instrumenta vlerësimi, materiale mësimore) ose kanë konfuzion për këto terma. Në ndonjë rast shihet edhe një mungesë serioziteti në plotësimin e pyetësorit dhe kjo kuptohet nga fakti që nuk jepen fare përgjigje, jepen përgjigje krejt identike për pyetje të ndryshme, ose jepen përgjigje të ndryshme për të njëjtën kërkesë. Ka edhe përgjigje me besueshmëri të ulët, p.sh., që një modul praktik realizohet 100% në mësimin online.



Një nga vështirësitë që nuk shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë por nënkuptohet, është edhe mungesa e dëshirës dhe motivimit të një pjese të nxënësve për tu angazhuar aktivisht në procesin mësimor online dhe këtë mundohen ta justifikojnë me mungesën e internetit, të pajisjeve të përshtatshme të komunikimit ose aplikacioneve të nevojshme.

Nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve rezulton që përdorimin më masiv për *komunikim në mësimin online* e ka aplikacioni “WhatsApp” i instaluar në smartphon-ët e mësuesve, nxënësve ose prindërve të tyre. Është i shpejtë dhe thjeshtë në përdorim, instalohet në pajisje portabël, krijon mundësi për komunikim në grup, me zë dhe me figurë, ka kosto të ulët, por mbingarkon shpejt memorjen e telefonave të cilësisë së ulët dhe mesatare dhe krijon vështirësi në transmetimin e materialeve voluminoze dhe në përgatitjen e detyrave nga nxënësit.

Aplikacione të tjera si “Google classroom”, “Zoom”, “Skype” apo “Facebook” kanë përdorim më të kufizuar sepse kërkojnë trajnim paraprak, akses në internet dhe përdorimin e kompjuterave dhe laptopëve. Ndonjëherë kërkojnë edhe pagesë regjistrimi. Platforma “mesovet.al” ka përdorim të kufizuar dhe dedikohet kryesisht për mësuesit, nxënësit dhe drejtimet profesionale e shkollave që mbështeten nga projekti S4J.

PROPOZIMET

Një nga qëllimet e pyetësorit është dhe marrja e informacionit për rrugët e mundshme të shmangies së vështirësive dhe përmirësimit të mësimit online në Arsimin Profesional. Më poshtë renditen *propozimet* më kryesore të mësuesve:


- Të ketë akses falas në internet për të gjithë nxënësit dhe mësuesit.
- Të përmirësohet infrastruktura (kompjuterat, telefona, tableta) e mësimit online.
- Të krijohet një platformë e posaçme për mësimin online në arsimin profesional
- Të trajnohen mësuesit për mësimin dhe vlerësimin online.
- Të aplikohen orare më të shkurtra për orët e mësimit online.

Përvoja e krijuar nga zbatimi i mësimit online në këto kushte emergjence, është një bazë e mirë për *shtrirjen e tij* në ato lëndë, tematika apo aspekte të veçanta të procesit mësimor edhe në kontekstin e rikthimit të procesit mësimor në kushte normale, kur mundëson rritjen e efektivitetit dhe efijencës, si dhe lehtëson përmbushjen e shpejtë të objektivave mësimore nga nxënësit.

Pyetja 3: A e keni lexuar Udhëzuesin për mësimin në kushtet e shtëpisë në AP?

Janë përgjigjur gjithsej 454 mësues e instruktorë (M/I), nga këta:

- janë përgjigjur pozitivisht 431 mësues e instruktorë;
- janë përgjigjur negativisht 3 mësues e instruktorë;
- nuk janë përgjigjur 20 mësues e instruktorë.




REZULTATET E PËRGJIGJEVE PËR ÇDO PYETJE

Dy kërkesat e para të pyetësorin përmbajnë të dhëna për mësuesin/instruktorin, shkollën profesionale dhe lëndët/modulet që ai trajton.

Më poshtë tregohen të dhëna statistikore dhe rezultatet e analizës së përgjigjeve për secilën nga 20 pyetjet në vijim që përmban pyetësori.

Pyetja 4: Cilin program/platformë përdorni aktualisht për komunikimin online me nxënësit?

Nga 454 përgjigje të dhëna nga mësues e instruktorë të AP në Shqipëri, vërehet që programet ose platformat më të përdorura në komunikimin online me nxënësit, renditen në tabelën e mëposhtme:



Nga një vështim i shpejtë i të dhënave të mësipërme, rezulton që aplikimi WhatsApp është më i përdorshëm në komunikimin online (370 mësues), i ndjekur nga Google classroom (79 mësues), ndërsa aplikacione të tjera kanë përdorim të ulët. Përveç atyre të treguara në tabelë, një numër shumë i vogël mësuesish i referohen edhe mënyrave të tjera të tilla si sms, instagram, sokrativ.

**PYETJA 5: CILAT PROGRAME/PLATFORMATË
TJERA KENI PROVUARTË PËRDORNI PËR
KOMUNIKIMIN ONLINE?**

Pjesa më e madhe, në përgjigjet e dhëna referuar kësaj pyetjeje theksojnë të njëjtat programe/platforma të cilat i kanë përmendur nëpërgjigjet e pyetjes 4, por edhe disa programe/platforma të tjera si Bukinist, Hangout, Meet, Messenger, Kahoot apo Big blue button. Rreth 120 mësues nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje ose tregojnë që nuk kanë provuar të përdorin aplikacione të tjera, përveç atyre që kanë treguar te pyetja 4. Vihet re një një moskuptim i drejtë të kësaj pyetjeje, pasi theksi duhet të ishte te ato aplikacione të cilat ata kanë tentuar t'i përdorin por nuk kanë patur sukses në përdorimin e tyre.


Pyetja 6: Nëse keni provuar programe/platforma të tjera, kush janë arsyet që nuk i përdorët më në vijim?

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga mësimdhënësit e AP, arsyet kryesore për mospërdorimin e programeve apo platformave të tjera të veçanta, përmbledhen si më poshtë:




Mungesa e aksesueshmërisë në internet nga të gjithë nxënësit/prindërit.


Mungesa e adresave të e-mailit.



Mungesa e mjeteve si kompjuter ose laptop, pasi një pjesë e aplikacioneve realizohen vetëm nëpërmjet këtyre mjeteve, me memorje të konsiderueshme.



Mungesa e trajnimit të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e aplikacioneve të veçanta.



Mungesa e kamerave për kompjuterat.




Vështirësia e përdorimit të programeve të veçanta (nxënësit e mësuesit parapëlqejnë ato aplikacione me të cilat janë familjarizuar)
Përdorimi i disa aplikacioneve të veçanta bëhet kundrejt pagesës.

Duhet theksuar se përveç vështirësive logjistike, mospërdorimi i aplikacioneve të posaçme për mësimin online lidhet edhe me mungesën e vullnetit dhe të gadishmërisë së mësuesve dhe nxënësve për të investuar kohë dhe energji në përmirësimin e mësimin online.

Pyetja 7. Çfarë mjetesh\pajisjesh përdorni për komunikimin online me nxënësit?

Në shumë nga përgjigjet e mësuesve, vihet re që ka një moskuptim të drejtë për **mjetet** dhe **pajisjet** që përdoren për komunikimin online dhe ngatërrohen me aplikacionet (WhatsApp, Zoom etj.) apo me llojet e materialeve mësimore (foto, video etj.).



Vihet re që masivisht përdoret aparati telefonik celular për mësimin online, po kështu vetëm një pjesë e vogël e nxënësve përdorin kompjuterin ose laptopin në kushtet e shtëpisë.

Nr	Mjetet\pajisjet për komunikimin online	Shpeshtësia e përdorimit
1	Celulari	329
2	Kompjuteri personal	153
3	Laptopi	120

PYETJA 8. ÇFARË VËSHTRËSISH/PENGESASH KENI HASUR NË KOMUNIKIMIN ONLINE ME NXËNËSIT?


- Kushte të papërshtatshme gjatë mësimin online në shtëpi.
- Mbingarkesë e mësuesve nga angazhimi me shumë nxënës njëkohësisht.
- Volum i madh kohe për parapërgatitjen e mësuesve dhe vlerësimin e detyrave.
- Mosnjohje, nga ana e mësuesve dhe nxënësve, e aplikacioneve për mësimin online.
- Pamundësi për realizimin online të moduleve praktike të veçanta.

Mësuesit rendisin një numër të madh pengesash që vështirësojnë ose pengojnë realizimin optimal të mësimin online në kushtet e shtëpisë. Pengesat më kryesore të këtij procesi rezultojë:

- Një pjesë e nxënësve nuk i frekuentojnë seancat e drejpërdrejta online ose nuk i përgjigjen thirrjeve të mësuesve apo detyrave që ata u japin nxënësve.
- Mungesa e kontakteve me nxënësit gjatë seancave online ose ndërprerja e tyre.
- Mungesa e vullnetit dhe pasiviteti i nxënësve, edhe në rastet kur ata e frekuentojnë seancën online.
- Lodhja dhe humbja e përqendrimit të nxënëve gjatë seancave për disa lëndë gjatë ditës.
- Mos-koordinimi i orareve dhe mbivendosja e seancave online.

Pyetja 9. Sa është përqindja e përafërt e pjesëmarrjes së nxënësve tuaj në mësimin online?

Nga analiza e përgjigjeve për këtë pyetje, vihet re që ka perceptim shumë të ndryshëm të mësuesve në lidhje me shkallën e pjesëmarrjes së nxënësve online, dhe kjo ndikohet shumë nga lëndët apo modulet që ata trajtojnë, nga rajoni ku ndodhet shkolla dhe mundësia për akses online, nga niveli ekonomik i familjeve të nxënësve etj.



N r	Përqindja e përafërt e pjesëmarrjes së nxënësve online	Numri i përafërt i mësuesve
1	100%	35
2	90%	120
3	80%	130
4	70%	95
5	60%	35
6	50%	20
7	40%	10
8	Më pak se 40%	5


Pyetja 10. Cilat janë shkaqet kryesore që vështirësojnë ose pengojnë pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin online?

Mësuesit në përgjigjet e tyre rendisin shumë shkaqe që krijojnë vështirësi në zbatimin e mësimit online, por ka një konsensus të madh në lidhje me tri shkaqe kryesore, si më poshtë:

- Mungesa e plotë, ndërprerja ose dobësia e lidhjes së internetit (më shumë se 75% e përgjigjeve)
- Mungesa e aparateve telefonikë celularë të përshtatshëm për mësim online
- Mungesë e kompjuterave personalë ose e laptopëve

Përveç shkaqeve të mësipërme, mësimi online vështirësohet edhe për shkak të kushteve jo të përshtatshme në shtëpi, ngarkesës psikologjike si rrjedhojë e situatës aktuale, mungesës së valëve telefonike në zona të veçanta, përdorimit të telefonëve të prindërve, mbingarkesës së memorjes së telefonit, mungesës së kapacitetit për instalim aplikacionesh për mësimin online. Edhe indiferenca apo mungesa e motivimit të nxënësve, mospërshtatja me mënyrën e re të mësimit online janë faktorë që ulin efektivitetin e mësimit në kushte shtëpie. Vlen për t'u theksuar se disa nga pengesat e mësipërme e kanë burimin te vështirësitë ekonomike të një pjese të familjeve të nxënësve.

Shkaqet kryesore që vështirësojnë/pengojnë pjesëmarrjen e nxënësve



Pyetja 11. Çfarë propozoni për të mundësuar rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në mësimin online?

Në propozimet e mësuesve për përmirësimin e pjesëmarrjes së nxënësve në mësimin online një vend të rëndësishëm zë rritja e aksesit për internetin dhe mundësi që ai të ofrohet falas për nxënësit dhe mësuesit e shkollave. Gjithashtu një vend të rëndësishëm në propozimet e mësuesve zë ideja për krijimin e një platforme të re, të veçantë për arsimin profesional, kombëtare ose me bazë shkolle.

Bashkëpunimi mësues, prindër, nxënës si dhe trajnimi i mësuesve për metodologjitë e mësimin online janë gjithashtu propozime të bëra nga një pjesë e vogël e mësuesve.

Nr	Propozimet për rritjen e pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin online	Numri i përafërt i mësuesve
1	Lehtësi aksesit në internet	195
2	Platformë mësimdhenie më efikase	93
3	Bashkëpunimi mësues, nxënës, prindër	10
4	Trajnimi i mësuesve për mësimin online	11
5	Asnjë propozim	20

Përveç propozimeve që janë në tabelë, një pjesë e mësuesve propozojnë edhe pajisjen e nxënësve me kompjutera, laptopa, tableta, telefona, si dhe ofrimin falas të internetit dhe komunikimit telefonik për nxënësit dhe mësuesit. Mbështetja nga prindërit, metodat interaktive dhe ofrimi i emisioneve televizive për nxënësit e shkollave profesionale, këto janë disa nga propozimet e një numri të vogël mësuesish.


Eshtë për t'u vënë në dukje fakti që shumë mësues nuk kanë propozuar asnjë ide për përmirësimin e mësimin online.

Pyetja 12: Listoni sipas shpeshtësisë, metodat/mënyrat kryesore që përdorni për mësimin online

Në shumë nga përgjigjet e mësuesve, vihet re që ka një moskuptim të drejtë për *metodat* dhe *mënyrat* mësimore dhe ato ngatërrohen me mjetet dhe mediat e ndryshme që ata përdorin në mësimin online të tilla si telefoni, kompjuteri, ehatsapp, mesoVET.al, e-mail, mesazhe zanore etj. Gjithashtu, në grupin e metodave mësimore shpesh janë futur edhe instrumente vlerësimi si pyetje-përgjigje dhe teste me shkrim.

Në këto ilustrime listohen 15 metodat/mënyrat mësimore më të shpeshta, por te përgjigjet e mësuesve hasen edhe metoda/mënyra që përdoren shumë rrallë, të tilla si dhënie projektesh, harta e mendjes, konsultime individuale, hulumtim etj.

Vihet re që më së shumti përdoren metodat ilustruese për aspektet teorike dhe praktike (video ilustruese dhe foto), ndërsa metodat më komplekse dhe interaktive si puna në grupe, demonstrimi dhe projektet mësimore përdoren shumë pak.




Pyetja 13: Listoni sipas shpeshtësisë, disa materiale mësimore që përdorni për mësimin online

Ka raste kur përgjigjet nuk i referohen kërkesës për materialet mësimore që ata përdorin, por kanë të bëjnë me aspekte të tjera si mënyrat e transmetimit (e-mail, whatsapp) apo pajisjet që përdoren (celular, laptop).


Vihet re që mësuesit përdorin një llojshmëri e madhe të materialeve mësimore, por shkalla e përdorimit është me diferenca të mëdha. Videot dhe materialet e shkruara në formë teksti zenë pjesën kryesore. Përveç materialeve mësimore të përfshira në tabelën dhe grafikuan e mësipërm, mësues të veçantë përmendin edhe materiale të tilla si guida mësimore, literaturë shtesë, detyra, ushtrime, studime rasti, materiale të portalit Shkëmbim AFP, materiale të Al-Tour etj.

PERDORIMI I MATERIALEVE
MESIMORE ONLINE



Pyetja 14: Listoni sipas shpeshtësisë, disa materiale mësimore që përgatitni ju vetë.


Në përgjithësi, mësuesit pohojnë që, në mungesë të teksteve mësimore dhe burimeve të tjera, ata i përgatisin vetë një pjesë të materialeve mësimore të cilat i përdorin edhe për mësimin online, kryesisht duke u bazuar te interneti dhe tekstet e ndryshme të mëparshme.



Bie në sy që më shumë se 30% e mësuesve deklarojnë që përgatisin vetë video mësimore (konkretisht, përpunojnë audion e videove të shkarkuara nga interneti). Shumica e materialeve që përgatisin vetë kanë të bëjnë me ilustrime pamore (video, skema, skica, foto) dhe më pak materialet tekstuale (udhëzuesia, ushtrime, detyra). Një pjesë e vogël e mësuesve përmendin edhe materiale të tilla si flipçarte, pankarta, regjistrime audio etj.

Pyetja 15: Listoni sipas shpeshtësisë, burimet kryesore (platforma, faqe interneti, agjenci) ku ju gjeni materiale mësimore.

Burimet e informacionit




Përgjigjet e kësaj pyetje përgjithësisht janë të drejtpërdrejta dhe të qarta dhe tregojnë një llojshmëri të madhe burimesh informacioni ku mësuesit gjejnë jo vetëm materialet mësimore të gatshme që i shkëmbejnë me nxënësit, por edhe “brumin” me të cilin përgatisin vetë materialet që i’u nevojiten.

Për shumicën e mësuesve, interneti dhe motorët kërkimorë e faqet që lidhen me të (google, youtube), janë burimi kryesor ku mësuesit gjejnë materialet mësimore që përdorin në mësimin online. Një burim i rëndësishëm për materialet mësimore rezulton të jetë dhe faqja e AKAFPK-së. Përveç burimeve të informacionit që përmban tabela e mësipërme, një pjesë e vogël e mësuesve përmedin si burime të tjera si literaturën e publikuar, trajnimet e ofruara nga projektet e Kulturkontakt, Sëisscontact ose platforma të ndryshme. Bie në sy fakti që platforma “Shkëmbim AFP”, megjithëse ka dy vjet që është operative dhe ka rreth 230 anëtarë të regjistruar, përmendet shumë pak si burim materialesh mësimore.

	AKAFPK	Youtube	Interneti	Google	Libra, tekste	Mësovet .al	Platforma të ndryshme	Wikipedia	Facebook
■ Shpeshtësia e përdorimit	141	116	112	95	83	65	27	19	12

Pyetja 16. Listoni sipas shpeshtësisë, mënyrat me të cilat vlerësoni nxënësit (teste, detyra etj.)

Mënyrat e vlerësimit online



Më sipër listohen metodat e vlerësimit të nxënësve më të shpeshta që përdorin mësuesit në mësimin online, por te përgjigjet e tyre hasen edhe instrumente vlerësimi që i përdorin më rrallë, të tilla si pyetësorë, quize, ese, problema, punë të pavarura, portofole, teste në google forms dhe google classroom etj. Ndërsa një pjesë jo e konsiderueshme e mësuesve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Nga përgjigjet e mësuesve vihet re që shumica e tyre përdorin mënyrat më tradicionale të vlerësimit të nxënësve me detyra, teste, miniteste. Në një pjesë të përgjigjeve, tregohen edhe mënyrat (whatsapp, e-mail, sms, telefon etj.) me të cilat transmetohet informacioni për vlerësimin e nxënësve, megjithëse kjo nuk kërkohet. Në grupin e metodave të vlerësimit, shpesh janë futur edhe instrumente vlerësimi të fokusuara te modulet profesionale si pyetësor, projekt apo dhe listë kontrolli për vlerësimin e detyrave të thjeshta.



Shume fiktive

5%




Pjeserisht fiktive

80%



Nuk I janë përgjigjur
pyetjes

3%



Aspak fiktive

12%

Pyetja 17. Sa fiktive i gjykoni përgjigjet e nxënësve online (aspak; pjesërisht; shumë fiktive)?


Për këtë pyetje pjesa më e madhe e mësuesve (rreth 80%) janë shprehur se përgjigjet e nxënësve janë pjesërisht fiktive, pasi duke u përgjigjur nga shtëpia, kanë mundësinë e përdorimit të teksteve, gjetjes së përgjigjeve të gatshme në internet, por nuk përjashtohet ndihmesa e dhënë nga prindërit.

Pyetja 18. Çfarë propozoni që të ulët fiktiviteti i vlerësimit të nxënësve online?



Në këtë pyetje, ajo që bie në sy menjëherë është se një numër i madh mësuesish, 37% e totalit, nuk e kanë plotësuar fare, që mund të interpretohet si indiferencë, paqartësi ose mungesë idesh për uljen e fiktivitetit të vlerësimit. Po kështu, një pjesë tjetër e konsiderueshme e mësuesve, 27% e totalit, kanë dhënë përgjigje që nuk përputhet me kërkesën e kësaj pyetjeje ose japin përgjigje që përsëriten.

Një grup tjetër mësuesish mendojnë se përmirësimi i komunikimit të drejtpërdrejtë, detyrat dhe testimet individuale për secilin nxënës ulin fiktivitetin e vlerësimit, pasi komunikimi në grup ka vështirësi në aspektin e vlerësimit të tyre.



- Detyra dhe testime individuale për secilin nxënës
- Krijimi i aplikacioneve të posaçme
- Testet të zhvillohen njëkohësisht për të gjithë nx.
- Internet pa limit dhe pajisje portabël
- Përgjigje që s'kanë lidhje me pyetjen ose përsëriten




Disa mësues të tjerë mendojnë se krijimi i aplikacioneve të posaçme do të mund ta ulë fiktivitetin në vlerësimin e nxënësve online. Propozojnë që të realizohen videokonferenca si psh. nëpërmjet aplikacionit Zoom, si dhe të realizohen miniteste online me anë të Google forms.

Një nga ndërhyrjet që propozohet është dhe garantimi i internetit pa limit, si dhe pajisja me mjete portabël të komunikimit online. Këto do të lehtësonin mundësinë e kontaktit pamor me nxënësit, e si rrjedhojë do të ulnin fiktivitetin e vlerësimit të nxënësve online.

Mësuesit e praktikave profesionale janë shprehur se është shumë e vështirë që modulet praktike, si dhe vlerësimi i nxënësve, të mund të realizohen online. Përgjithësisht, në realizimin e moduleve të praktikës profesionale, nxënësi duhet që të punojë në mjedise pune reale prandaj dhe vlerësimi online për aftësitë e fituara është praktikisht i pamundur.

Pyetja 19. Sa është % e përmbajtjes së lëndëve ose moduleve që mund ta trajtoni online?



Në lidhje me sasinë e përmbajtjes së lëndëve profesionale që mësuesit arrijnë të trajtojnë online jepen përgjigje të ndryshme sipas eksperiencave që ata kanë. Shumica e mësuesve e konsiderojnë më të mundshëm trajtimin online të lëndëve profesionale, ndërsa për modulet profesionale mendojnë që pjesët praktike të tyre paraqesin vështirësi të realizohen online.

Analiza statistikore tregon që pothuajse gjysma e mësuesve mendojnë se ata mund të trajtojnë online rreth 90-100% të përmbajtjes së lëndëve profesionale dhe pothuajse një e treta e tyre mendon se kjo përqindje realizohet edhe për modulet praktike. Këto janë shifra me besueshmëri të ulët duke konsideruar vështirësitë dhe pengesat e treguara në përgjigjet e pyetjeve të mësipërme (veçanërisht te pyetjet 8, 9 dhe 10).

Pyetja 20: A keni kontakte/shkëmbime me mësues të të njëjtës lëndë/modul në shkolla të tjera?

Nga përgjigjet e dhëna vihet re që kemi pothuajse një barazi ndërmjet përgjigjeve pozitive dhe atyre negative në lidhje me kontaktet/shkëmbimet me mësues të të njëjtës/it lëndë/modul në shkolla të tjera.

Disa mësues, përveç përgjigjes “Po” ose “Jo”, japin edhe sqarime plotësuese ku tregojnë që kanë kontakte më shumë me mësuesit e tjerë të shkollës dhe kanë kontakte por jo shkëmbime me mësues të shkollave të tjera.

Në rastin e kontakteve me koleget në shkollat e tjera, këtë i’a adresojnë platformës “Shkëmbim AFP”, trajnimeve të zhvilluara si p.sh.trajnimet 24 ditore, trajnimeve nga S4J etj.

Një pjesë e papërfillshme e mësuesve pohojnë që kanë shkëmbime me mësues të tjerë, por këto shkëmbimeve janë të pakta.

Pyetja 21: Shkruani përparësitë e mësimit online

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të dhëna rezulton që renditen një numër shumë i madh përparësish të mësimit online, veçanërisht duke konsideruar situatën aktuale. Më poshtë, renditen në mënyrë të përmbledhur përparësitë kryesore të mësimit online:

- Eshtë i shpejtë, impenjativ dhe një praktikë metode bashkëkohore
- Paraqet fleksibilitet në orar.
- Realizohet trajtim më i strukturuar i leksioneve.
- Nxënësit janë me aktive, më të komunikueshëm, më bashkëpunues dhe më të lirë.

- I mban të lidhur mësuesit me nxënësit, si dhe vetë nxënësit me shkollën dhe mësimin.
- Mësimi on line mund të menaxhohet sukseshëm (por vetëm nëse ke një numër të ulët nxënësish).

- Krijon lidhje të ngushta të mësuesit me çdo nxënë.ë.
- Mundëson vetë-studimin dhe kreativitetin e nxënësve.
- Nxënësit janë të gjithë të barabartë në marrjen e informacionit.
- Mundëson përdorimin e platformave të ndryshme dixhitale

- Procesi i kontrollit për çdo nxënë.ë realizohet në kohë reale.
- Ka kosto relativisht të ulët.
- Nxit përgjegjshmërinë e nxënësve.

Një pjesë jo e konsiderueshme e mësuesve pohojnë që nuk shohin ndonjë përparësi të mësimit online ose rendisin disa mangësi të tij, të tilla si: mungon pjesa e aktivizimit praktik të nxënësve sepse nuk realizohen demonstrime, praktika të mbikqyrura e të pavarura, ka vështirësi për trajnimin e duhur online, krijohet distancim social etj.

Pyetja 22: Propozoni masa të mundshme për përmirësimin e mësimin online, në kushte shtëpie.

Ka këndvështrime shumë të veçanta në lidhje me masat që propozohen për të përmirësuar mësimin online, por në mënyrë masive vihet theksi te rritja e aksesit të internetit dhe përmirësimi i infrastructures për mësimin online, në kushte shtëpie. Më poshtë tregohet një përmbledhje e këtyre propozimeve:

Të ketë akses për të gjithë nxënësit dhe mësuesit ne internet.

Të gjithë nxënësit të përfitojnë internet falas

Të përmirësohet infrastruktura (kompjuterat, telefona, tableta) e mësimin online.

Të përdoren më shumë platformat “google classroom” dhe “zoom”.

Të trajnohen mësuesit për mësimin dhe vlerësimin online.
Të aplikohen orare më të shkurtra për orët e mësimin online.

- Të krijohet një platformë e posaçme për mësimin online në arsimin profesional

Nga analiza e përgjigjeve, rezulton që rreth 20% e mësuesve nuk i japin përgjigje kësaj pyetjeje.